




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**Të diskutimit të përgjithshëm publik, mbajtur më 11.09.2019, duke filluar në orën 14:00.**

**Morën pjesë: Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Vasilika Zotaj, drejtoresh e Drejtorisë së Administratës dhe Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit.**

Të pranishëm ishin edhe: Dren Shahini, banor nga lagjja “Mati 1”- “Bregu i Diellit”, Agim Gashi, anëtar i Kuvendit të Komunës, Shefki Gashi, anëtar i Kuvendit të Komunës, Halim Halimi, anëtar i Kuvendit të Komunës, Naime Osmani, anëtare e Kuvendit të Komunës, dhe Mustafë Krasniqi, anëtar i Kuvendit të Komunës.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, i cili tha se në koordinim me kryesuesin e Kuvendi dhe me Komitetit për Politikë dhe Financa, kemi pasur për qëllim që të mbajmë edhe një diskutim bashkërisht, me qëllim të dhënies së mundësisë që qytetarët t’i adresojnë kërkesat e tyre.

**Valbona Makolli**, drejtoreshë, tha se buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prishtinës për vitin 2020 është 91 milionë e 579,503 euro.

Ne kuadër të këtij buxheti janë të ndara, prej grandit të përgjithshëm 19 milionë 925,554 euro, grandit specifik për shëndetësi 7 milionë e 527,953 euro, grandit për arsim është 23 milionë e 90,533 euro dhe të hyrat vetanake janë 29 milionë e 258,367 euro, prandaj ne jemi këtu me i dëgjuar kërkesat për ndonjë propozim rreth këtij buxheti.

**Dren Shahini** tha se tash e sa vite radhazi kërkesat e njëjta i adresojmë, por nuk ka asnjë ndryshim, andaj kjo tregon shumë për punën që e bën qeverisja lokale.

Tani veç jemi në mes të muajit të nëntë të vitit 2019-së, dhe ende nuk janë organizuar zgjedhjet për bashkësisë lokale. Pa u funksionalizuar bashkësitë lokale, qytetarët nuk do të kenë ku t’i adresojnë kërkesat e tyre.

**Agim Gashi** fillimisht kërkoi të dijë arsyen se pse buxheti nuk është planifikuar në harmoni me Kornizën buxhetore afatmesme, p.sh. të hyrat janë shumë më pak edhe këtë vit, d.m.th. ka rënie në planifikim, dhe çështja tjetër është mënyra e shpërndarjes së

buxhetit nuk ka indikacione se ka me qenë një buxhet zhvillimor dhe në harmoni me kërkesat e qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Prishtina i ka disa probleme të mëdha. Problemi më i madh është sistemi i kolektorëve. Këtu nuk e pash asnjë metër gjatësi kolektor të planifikuar, kur dihet që me kilometra ujërat e zeza lëvizin mbi sipërfaqe, nga Zllatarit deri te lagjja "Kalabria", ku takohet me kolektorin e qytetit.

Problemi i pazgjidhur është edhe pjesa prej Pallatit të Drejtësisë deri në Çagllacvicë.

Sa i përket infrastrukturës shkollore, shumë pak është investuar. Ku janë 7 shkolla, të kapacitetit mbi mesatare, që i mungojnë komunës së Prishtinës, brenda qytetit.

Është propozuar që të rrënohet objekti i ish- Shkollës Teknike, por ai objekt nuk duhet të rrënohet, duhet të rinovohet, restaurohet, nëse është objekt i mbrojtur, sepse është pjesë e identitetit kulturorë të Prishtinës.

Hapja e parqeve të reja në qytet, pra nuk mund të mirëmbahen parqet pa e pasur edhe sistemin e ujitjes.

Gjithashtu, vitin e kaluar kanë qenë të projektuara 500,000 euro për ndërtimin e rrugës "Agim Ramadani", dhe nuk shihet se është ndërtuar diçka në atë rrugë, pra kemi edhe më se 30 - 40 projekte të tilla që kanë mbetur pa u realizuar.

**Shefki Gashi** tha se ka më se 6 vjet që nuk është investuar as në infrastrukturë, as në arsim, por as në shumë fusha të tjera. Jo vetëm parqet, por komplet territori i Prishtinës është shndërruar në kaos. Kjo mënyrë e ndarjes së buxhetit në këtë formë, me këtë mbetje të mjeteve 5-6 milionë euro bartje, kjo nuk është në rregull.

**Dren Shahini** tha se mungesa e bashkësive lokale e sjell edhe mungesën e qytetarëve në këto diskutime. Do të kishte qenë mirë që edhe ne qytetarët ta kishim para vetes këtë projektbuxhet.

Shqetësim tjetër për qytetarë ka qenë edhe marrja e vendimit për Planin rregullues të Fakulteti Teknik dhe të "Dodona", e që asnjëri nga përfaqësuesit e drejtorive komunale nuk kanë dalë me diskutuar me qytetarë. Pjesa nën Fakultetin Teknik është e vetmja hapësirë gjelbëruese për banorët e asaj zone. Edhe lokacioni ku do të ndërtohet Ambasada gjermane, është një hapësirë me më se 200 pisha shumëvjeçare, të cilat duhet të hiqen nga aty, andaj ne konsiderojmë se kjo nuk është dashtë të bëhet, pasi që nuk janë konsultuar fare qytetarët.

**Halim Halimi** u shpreh se ato të cilat i ka votuar Kuvendi komunal, unë nuk i kam votuar, sepse ato plane janë pa hartën zonale dhe të kundërligjshme.

Shumë pak është punuar në infrastrukturën rrugore, p.sh. rruga Keqekollë - Nishevc, që tri vjet janë mbetur edhe dy kilometra pa u shtruar.

**Fatime Hajdari**, drejtoreshë, tha se për mirëmbajtjen e parqeve janë 200,000 euro, dhe vetëm sivjet ka pasur hapje mbi 19 puse të reja dhe shtrirje të sistemit të ujitjes. Besoj se edhe gjatë vitit 2020 do të punojmë intensivisht në këtë drejtim.

**Vasilika Zotaj**, drejtoreshë, bëri të ditur se për shkak të zgjedhjeve të nivelin qendror, të cilat do t'i kemi tani, nuk mund të ketë zgjedhje për bashkësitë lokale, pra kjo është arsyeja që janë shtyrë zgjedhjet për bashkësitë lokale.

**Naime Osmani** tha se unë si anëtare e Kuvendit të Komunës, që 6 vjet i kamë parashtruar të njëjta pyetje, për pjesët e qytetit dhe pjesët rurale. Tash e 6 vjet, një rrugë është shtruar, rruga Rimanishtë-Siqevë, por nuk ka shkuar deri në fund, ka shkuar vetëm deri te

lagjja e fundit e Rimanishtës. Pse nuk ka përfunduar kjo rrugë?!

Kanë qenë shumë kërkesa për lagjen "Kodrën e Trimave", për Lagjen e Spitalit, për rrugën "Gazmend Zajmi" etj., projekte të cilat kanë mbetur pa u realizuar. Andaj, propozoi që të realizohen nga ky buxhet.

**Valbona Makolli**, drejtoreshë, theksoi se propozimbuxheti nuk është i publikuar, publikohet pasi të aprovohet në Kuvend. Qëllimi i këtij takimi është me pasur ndonjë propozim konkret, sepse është propozimbuxhet.

**Dren Shahini** tha se në këtë propozimbuxhet po shihet që rruga "A" nuk është fare e përfshirë.

**Osman Bllaca** bëri të ditur se rruga "A" është në kompetencë të Qeverisë.

**Mustafë Krasniqi** theksoi se të gjitha ato vërejtje që u thanë këtu, janë propozime konkrete, duke filluar prej kolektorit, rrugës "A", vazhdimit të rrugës "B", trotuaret në pjesën e Unazës së jashtme të qytetit etj. Të gjitha këto kërkesa duhet të merren parasysh dhe të planifikohen në buxhet.

**Agim Gashi** ceku se është më se i domosdoshme zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat: Grashticë, Mramor, Slivovë. Po ashtu, është shumë i nevojshëm edhe rregullimi i trotuarit në projektin rrugor në fshatin Mromor, me gjatësi prej 4 km, që po e realizon Ministria e Infrastrukturës, në relacionin Prishtinë - Gjilanit.

**Naime Osmani** kërkoi që të shtrohen rrugët në Besi dhe të mirëmbahet rruga Besi - Rimanishtë, të rregullohen disa rrugë në Bardhosh, si dhe të bëhet asfaltimi i disa rrugëve në lagjen "Kodra e Trimave".

**Debati publik përfundoi në orën 15:30.**